VENDIM
Nr. 82, datë 24.4.2025

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 241, DATË 2.12.2021, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'ALBESP TRADING & CONSULTING' SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, me nr. 1367/2 prot., datë 18.4.2025, "Mbi miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 241, datë 2.12.2021, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'AlbEsp Trading & Consulting', sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike"'.

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k.

- Shoqëria "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k. është licencuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 241, datë 2.12.2021, për të ushtruar veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike për një periudhë 5-vjeçare. Me fillimin e operimit, kjo shoqëri duhet të depozitojë pranë ERE-s informacion mbi sistemin e saj IT, si dhe të paraqesë kontratën e qirasë së zyrave që disponon, brenda një afati prej një muaji nga data e rinovimit.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Në kuadër të raportimeve periodike, me shkresën nr. 1221/4 prot., datë 6.3.2025, shoqëria ka depozituar informacion mbi veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me anë të së cilës raporton se e ushtron aktivitetin e furnizimit.
- Në vijim, ERE, me shkresën nr. 1367 prot., datë 18.3.2025, ka kërkuar nga shoqëria:
- depozitimin e informacionit mbi sistemin IT;
- dorëzimin e kontratës së qirasë, me një afat vlefshmërie të përputhshëm me afatin e licencës, deri më 2.12.2026;
- me shkresën nr. 1367/1 prot., datë 27.3.2025, shoqëria ka depozituar informacion mbi sistemin IT, i cili përfshin:
- implementimin e një *firewall*-i për sigurinë e të dhënave;
- përdorimin e platformës OST Novita për nominime tregtare;
- regjistrimin në SEECAO dhe përdorimin e platformës Damas për blerjen e kapaciteteve;
- regjistrimin në ALPEX dhe përdorimin e platformës ETSS për operimin në treg;
- përdorimin e sistemit Dev Pos për procesin e faturimit.

Gjithashtu, bashkëlidhur kësaj shkrese shoqëria ka dorëzuar kontratën e qirasë, me afat vlefshmërie 3 (tre) vjet, nga data 1.11.2022 deri më 1.11.2025, ku parashikohet mundësia e shtyrjes automatike të afatit me një periudhë të njëjtë.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me pikën 2.4, germa "b", të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu, informacion mbi sistemin IT me të cilin do të operojë veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi, me qëllim realizimin e procesit të faturimit për klientët.

Në këtë kuadër, shoqëria ka përmbushur kushtin e parashikuar në pikën 2, të vendimit nr. 241/2021, dhe kjo pikë vlerësohet të shfuqizohet.

- Për sa i përket pikës 3, dokumentacioni i dorëzuar dëshmon për një kontratë qiraje të vlefshme deri më 1.11.2025, ndërkohë që licenca është e vlefshme deri më 2.12.2026. Plotësimi i këtij kushti është i pjesshëm, ndaj kjo pikë vlerësohet të ndryshohet për të përcaktuar afatin e saktë të detyrimit për depozitimin e kontratës pas rinovimit, si më poshtë vijon:

3. Shoqëria "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e qirasë së zyrave që disponon, jo më vonë se 1 (një) muaj pas rinovimit të saj (afati i përfundimit data 1.11.2025).

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

Bazuar në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", një akt administrativ mund të shfuqizohet ose ndryshohet nga vetë organi që e ka nxjerrë, në mënyrë të pjesshme apo të plotë, dhe gjithmonë me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2021, shfuqizohet.

2. Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2021, bëhet pika 2 dhe formulohet si vijon:

"2. Shoqëria "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e qirasë së zyrave që disponon, jo më vonë se një (1) muaj pas rinovimit të saj (afati i përfundimit: 1.11.2025).".

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në përputhje me përmbushjen ose jo të detyrimit të përcaktuar në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2021, i ndryshuar.

4. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve të njoftojë shoqërinë "AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti